



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/ 02-30042/23
Kaçanik, 30.11.2023

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (b), (c), (f) të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), të nenit 24 dhe nenit 25 të Ligjit Nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ((Gazeta Zyrtare Nr. 10/03 Prill 2019), të neni 29.5 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 6.2 (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, duke vendosur sipas Propozim Vendimit Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që Kuvendi i Komunës 01Nr. 104/02-30042/23 prej datës 16.11.2023, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 30 nëntor 2023, mori këtë:

VENDIM

PËR SHPALLJE NË INTERES PUBLIK TË PARCELAVE KADASTRALE NË ZONËN KADASTRALE KAÇANIK DHE KOXHAJ

1. Me këtë vendim, SHPALLEN në interes të përgjithshëm publik, Parcelat kadastrale të pronës së paluajtshme në Zonën kadastrale Kaçanik.
2. Sipas pikës 1. të këtij vendimi, Parcelat kadastrale që do të shpallen me interes publik të pronës së paluajtshme në Zonën kadastrale Kaçanik, në pronësi private të personit fizik dhe juridik, janë si vijon:
 - 2.1 Parcela Kadastrale P-70917048-00644-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S=973.3 m^2$, në pronësi Komuna e Kaçanikut, me vendodhje Rr " Ismail Raka ", ZK Kaçanik (të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $59 m^2$, e cila nevojitet për zgjerimin e hapësirës publike).
 - 2.2 Parcela Kadastrale P-70917048-00643-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S=202.4 m^2$, në pronësi të personit Adnan (Feriz) Vishi , me vendodhje Rr. "Sali Bajra", ZK Kaçanik, (të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $56 m^2$, e cila nevojitet për zgjerimin e hapësirës publike).
 - 2.3 Parcela Kadastrale P-70917048-01909-15, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S=2528.8 m^2$, në pronësi Komuna e Kaçanikut, me vendodhje Rr " Emsale Frangu ", ZK Kaçanik, (të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $42.41 m^2$, e cila nevojitet për rregullimin e rrugës " Emsale Frangu" Kaçanik).

2.4 Parcela Kadastrale P-70917048-00153-24, me sipërfaqe të përgjithshme prej S= 202.2 m², në pronësi të personit Ramiz (Afiz) Shaqiri , me vendodhje Rr “ Emsale Frangu ”, ZK Kaçanik, për rregullimin e rrugës Kaçanik (të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe 27.47 m², e cila nevojitet për rregullimin e rrugës “ Emsale Frangu” Kaçanik).

3. Me këtë vendim, SHPALLEN në interes të përgjithshëm publik, Parcelat kadastrale të pronës së paluajtshme në Zonën kadastrale Koxhaj.

4. Sipas pikës 3. të këtij vendimi, Parcelat kadastrale që do të shpallen me interes publik të pronës së paluajtshme në Zonën kadastrale Koxhaj, në pronësi private të personit fizik dhe juridik, janë si vijon:

4.1 Parcela Kadastrale P-70917093-00545-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej S= 860.5 m², në pronësi Komuna e Kaçanikut, Rrugët Publike dhe të Pakategorizuar, me vendodhje Rr “ Ramadan Xhokli”, ZK Koxhaj. (të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe 41.72 m², e cila nevojitet për rregullimin e rrugës “ Ramadan Xhokli”).

4.2 Parcela Kadastrale P-70917093-00544-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej S= 2287 m², në pronësi të personit Mejdi (Azem) Deda , me vendodhje Rr. “ Ramadan Xhokli”, ZK Koxhaj. (të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe 41.72 m², e cila nevojitet për rregullimin e rrugës “Ramadan Xhokli”).

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli